

Komponentja nxitëse dhe llogaritja e çmimit të disbalancës.

Referuar Rregullave të TSHB miratuar me Vendim të ERE, nr. 106, datë 2.70.2020, Aneksi 12.4. pika 3.5 ku citohet:

3.5. Komponentja nxitëse

- a. Vlera fillestare: €/MWh
- b. Rregullimet e komponentes nxitëse

3.5.b.1. OST do të rregullojë komponentën nxitëse në bazë të kriterëve objektive sipas një procedure të përcaktuar dhe të publikuar nga OST në faqen zyrtare.

3.5.b.2. Vlera aktuale e komponentes nxitëse do të publikohet në faqen zyrtare të OST.

3.5.b.3. ERE ka të drejtën në çdo kohë të shqyrtojë procedurën për rregullimin e komponentes nxitëse dhe nëse është e nevojshme i kërkon OST ta dergojë këtë procedure për tu miratuar në ERE dhe ta përfshijë si pjesë e Rregullatve të Tregut Shqiptar të Balancimit.

OST do të rishikojë në vijim vlera e komponentes nxitëse nëse do të nevojiten ndryshime të saj duke u bazuar në sjelljen e tregut balancues dhe pjesëmarrësve. OST do të njoftojë paraprakisht ndryshimin e komponentes nxitëse para hyrjes së tyre në fuqi dhe do të marrë në shqyrtim sugjerimet e palëve lidhur me vlerat e komponentes nxitëse.

Nga data 1 prill 2021 deri në një njoftim për ndryshim të vlerave të komponentes nxitëse do të qëndrojë në fuqi komponentja nxitëse e barabartë me zero. Bazuar në formulat e llogaritjes së çmimeve të disbalancave referuar Rregullave të TSHB pas datës 1 prill 2021 çmimi i disbalancës do të llogaritet si në vijim:

Gjendja e Sistemit		Çmimi i Disbalancës llogaritet si:	
+1 (Sistemi ka tepriçë)	Pozitive	$P_{E.Bal} - K_{nx}$	
	Negative	$P_{E.Bal} + K_{nx}$	
-1 (Sistemi ka mungesë)	Pozitive	$P_{E.Bal} - K_{nx}$	
	Negative	$P_{E.Bal} + K_{nx}$	
0 (Sistemi është në balancë)	Pozitive	$P_{E.Bal} - K_{nx}$	
	Negative	$P_{E.Bal} + K_{nx}$	
2 (Sistemi ka disbalancë të dyanëshme)		Rasti A	Rasti B
	Pozitive	$P_{E.Bal} - K_{nx}$	$P_{Mes.Bal} - K_{nx}$
	Negative	$P_{Mes.Bal} + K_{nx}$	$P_{E.Bal} + K_{nx}$

Rasti A: Çmimi i energjisë balancuese në ulje < Çmimi mesatar i Energjisë Balancuese.

Rasti B: Çmimi i energjisë balancuese në ulje > Çmimi mesatar i Energjisë Balancuese.

$P_{E.Bal}$ – Çmimi i energjisë balancuese.

K_{nx} – Komponente nxitëse (Vlera fillestare = 0)

$P_{E.Bal}$ – Çmimi mesatar i energjisë balancuese.